



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.197/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2020 shqyrtoi ankesat me:

Objekt: “Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me objekt “Shërbimi i Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2020”, me Nr. REF-50346-02-13-2020, me fond limit 6.649.502 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 11.03.2020 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore”.

Ankimues: “Inpress” shpk
Rr “Siri Kodra”, ish blloku i magazinave, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV)
Rr. e Kavajës, ish- Uzina Mekanike, Hyrja 203, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 14.02.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit prokurimit “Kërkesë për propozime”, me objekt “Shërbimi i Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2020”, me Nr. REF-50346-02-13-2020, me fond limit 6.649.502 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 11.03.2020 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore”.

II.2. Në datën 11.05.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin e ofertave gjatë procesit të vlerësimit, si dhe ofertuesit e kualifikuar dhe të skualifikuar si vijon:

1.	"Inpress" shpk.	5, 796,623.00 Lekë	Skualifikuar
2.	"Albdesign PSP" shpk.	6,279,740.00 Lekë	Kualifikuar

II.3. Në datën 11.05.2020, operatori ekonomik "Inpress" shpk është njoftuar elektronikisht nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), për skualifikimin e tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

"Nuk ploteson kriterin lidhur me eksperiencën e ngjashme për shërbimin që kërkohej sikurse është specifikuar në DST (teknike) sa i përket mënyrës së zarfimit e cila është kërkuar nga autoriteti kontraktor të jetë "... zarfim automatik (insertimi)".

II.3.1. Në datën 14.05.2020 operatori ekonomik "Inpress" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin operatorit ekonomik "INPRESS" shpk. Konkretisht pretendohet si vijon:

"Ne vijim të procedurës së prokurimit publik të Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV)- Bashkia Tirane, me objekt: "Shërbimi i Printimit të Njoftimit Detyrimeve për vitin 2020", dhe me Fond limit : 6.649.502 (gjashtë milion e gjashtëqind e dyzetë e nentë mijë e pesëqind e dy) leke pa TVSH, publikuar me datë 14.02.2020, e cila u zhvillua me datë 11.03.2020 (afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave).

Vlerësimi i Ofertave të Tenderit për procedurën e prokurimit të lartpërmendur u zhvillua nga Autoriteti Kontraktor në datën 11.05.2020. Në këtë procedurë prokurimi paraqiten ofertat ekonomike operatorët ekonomikë të poshtshenuar, të cilët autoriteti kontraktor i klasifikoi në këtë mënyrë:

1.	"Inpress" shpk.	5, 796,623.00 Leke	Skualifikuar
2.	"Albdesign PSP" shpk.	6,279,740.00 Leke	Kualifikuar

Në njoftimin e marrë nëpërmjet sistemit elektronik të APP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) -Bashkia Tirane, u informuam se:

"Operatori Ekonomik "Inpress" shpk. është "skualifikuar" pasi nuk ploteson kriterin lidhur me eksperiencën e ngjashme për shërbimin që kërkohej sikurse është specifikuar në DST (specifikimet teknike) sa i përket mënyrës së zarfimit, e cila është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor të jetë "zarfim automatik" (insertimi)".

Duke qenë se ky vendim i KVO, të Autoritetit Kontraktor është i gabuar, dhe bie në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nenligjore të fushës, në fuqi, mbështetur në nenin 63 pika 2, të ligjit nr 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, në vijim të procesit të rivlerësimit të ofertave për tenderin dhe brenda afatit 7 ditë nga dita e nesërme e njoftimit nga ana e Autoritetit Kontraktor të këtij vendimi, Ju kërkojmë ndryshimin e këtij vendimi

te KVO-se te AK, duke parashtruar kundershite tona, si dhe arsytet ligjore ku bazohen keto kundershite, si vijon:

-Persa i perket vendimit te KVO te AK, per Skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Inpress" shpk., Ju paraqesim kundershite tona si vijon:

1. Ne Dokumentat Standarte te Tenderit per proceduren e prokurimit te lartpermendur , Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) - Bashkia Tirane eshte percaktuar se:

2.3 Per kapacitetin teknik:

"a. Pervoje e sukseshme ne kryerjen e sherbimeve me naryre te ngjashme ne nje vlere prej 40 % te fondit limit qe prokurohet, te realizuara gjate tre viteve tefundit te aktivitetit te operatorit.

Per ta vertetuar kete duhet:

- Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar me vertetimin e leshuar nga Institucioni shteteror per realizimin e plote dhe te sukseshem te kesaj kontrate, ku te jete e percaktuar kohezgjatja e sherbimit, vlere e sherbimit te realizuar.
- Kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese te nenshkruara nga te dyja palet (ku te shprehen qarte datat, shumet dhe sherbimet e realizuara).

2. Ne perputhje te plote me kerkesat e DST, Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., per te provuar pervojen e meparshme per kryerjen e sherbimeve me natyre te ngjashme ka paraqitur keto dokumenta:

i. Fature tatimore shitje, tek bleresi "Interlogistic" shpk., te produkteve me pershkrim : "Printim te dhenash version zarfa selfmailer", me vlere 465.418 (kater qind e gjashtedhjetete e pese mije e kater qind e tetembedhjetete) leke pa TVSH.

ii. Fature tatimore shitje, tek bleresi "Marketing & Distribution" shpk te produktit produkteve me pershkrim:"Printim te dhenash version zarfa selfmailer ", me vlere 2.501.000 (dy milion e pese qind e nje mije)leke pa TVSH.

iii. Fatura tatimore shitje, tek bleresi "Marketing&Distribution" shpk. te produkteve me pershkrim:

- "Etiketa vellim"
- "Bllok tre kopje"

Prodhi zarfa me ngjyra me element sigurie";

- "Tabele oraresh, format A 4 shtyp full color" ;
- "Liber ngjyrosje, format A5, shtyp full color, 2 ane, 12flete + kapak shtyp 1 ane full color" ; me vlere totale 238.887 (dy qind e tridhjetete e tete mije e tete qind e tetedhjetete e shtate) leke pa TVSH.

- iv. *Fatura tatimore shitje, tek bleresi "Studio Tartari" shpk. te produkteve me pershkrim:*
"Blloqe receta ";
"Blloqe flete votimi me elementie sigurie boje UV dhe nr. Serial";
"Katalog Promocional me punim special"; me vlere totale 450.229 (kater qind e pesedhjete mije e dy qind e njezete e nente) leke pa TVSH.
- v. *Fature tatimore shitje, tek bleresi "Interlogistic" shpk. te produkteve me pershkrim:*
"Blloqe fl. dalje, me nr serie ";
"Liber hyrje-dalje per personelin ";
"Procesverbale"; me vlere 14.748.510 (katerebeshjete milion e shtateqind e dyzete e tete mije e peseqind e dhjete) leke pa TVSH.
- vi. *Fature tatimore shitje, tek bleresi "Interlogistic" shpk. per produktet me pershkrim:*
"Blloqe fl . dalje me nr. serie ";
"Libra me nr. serie";
"Procesverbale me nr. serie "; me vlere 11.323.900 (njembeshjete milion e tre qind e njezete e tre mije e nente qind) leke pa TVSH.
- vii. *Kontrate furnizimi, fature tatimore, liste produktesh, vertetim realizimi, tek Autoriteti Kontraktor "Agjencia Shtetore e Kadastres" per produktet me pershkrim printim "Certifikata Pronesie", me vlere 349.000 (tre qind e dyzete e nente mije) leke pa TVSH.*
- viii. *Fatura tatimore shitjesh, tek bleres shkolla te ndryshme private per produktet me pershkrim:*
Printim "Deftesa";
Printim "Diploma";
"Regjistra & Amza ";
Printim "Certifikata"; me vlere 1.522.830 (nje million e pese qind e njezete e dy mije e teteqind e tridhjete) leke pa TVSH.
- ix. *Kontrate furnizimi, fature tatimore, liste produktesh, vertetim realizimi, tek Autoriteti Kontraktor "Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise" te produkteve me pershkrim:*
Printim "Deftesa";
Printim "Diploma";
"Regjistra & Amza ";
Printim "Certifikata"; me vlere 4.849.599 (kater million e tete qind e dyzete e nente mije e pese qind e nentedhjete e nente) leke pa TVSH.

3. *Bazuar ne dokumentacionin ligjor / teknik te mesiperem, te depozituar rregullisht nga Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., ne kete procedure prokurimi, vertetohet qartesisht se OE Inpress shpk, jo vetem qe e permbush plotesisht kriterin e kryerjes se sherbimeve me natvire te ngjashme, por e tejkalon ate disa here, si persa i perket cilesise, ashtu edhe sasise dhe volumit te sherbimeve me natvire te ngjashme.*

Ne dokumentat standarte te tenderit, fondi limit per proceduren e prokurimit ne fjale eshte 6.649.502 (gjashte milion e gjashteqind e dyzete e nentemije e peseqind e dy) leke pa TVSH. Sipas parashikimeve te DST, per te provuar kryerjen e sherbimeve me natvire te ngjashme, te meparshme OE duhet te paraqesin dokumentna qe provojne se pervoja e ngjashme kap vleren 40% te fondit limit.

Vlera 40% e fondit limit te procedures te prokurimit te larte permendur eshte 2.659.800,8 (dy milion e gjashte qind e pesedhjetete e nente mije e teteqind presje tete) leke pa Tvsh. Nderkohe Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., ka paraqitur dokumenta qe provojne pervojen e ngjashme ne vlere 36.449.373 (tridhjetete e gjashte milion e kater qind e dyzete e nente mije e tre qind e shtatedhjetete e tre) leke. Vlera qe eshte paraqitur nga Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., eshte disa here me e madhe se ajo qe kerkohet. Pra, sic e theksuam edhe mesiper, Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., jo vetem qe e ploteson kriterin e kryerjes se sherbimeve me natvire te ngjashme, te meparshme, por e tejkalon ate.

Gjithashtu, sic mund te vihet re lehtesisht nga te gjitha dokumentat e renditur me larte, Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., verteton se ka te gjitha kapacitetet dhe eksperiencat e meparshme te ngjashme per te kryer procedura shume me komplekse se ajo qe kerkohet ne DST.

Pra, pretendimi i Komisionit te Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane eshte teresisht i pasakte, i pabazuar ne fakte konkrete dhe reale si dhe i paligjshem keshtu qe per kete arsye duhet te ndryshohet.

4. Ne menyre me te detajuar do te donim te parashtronim gjithashtu, se Kornisioni i Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane, eshte shprehur ne njoftimin e bere nepermjet sistemit elektronik te Agjencise se Prokurimit Publik se Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., "...nuk ploteson kriterin lidhur me eksperiencen e ngjashme per sherbimin "zartim automatik" (insertimi)."

Sa i perket ketij pretendimi, nuk e kuptojme ku eshte bazuar Kornisioni i Vleresimit te Ofertave, qe ka dale ne kete konkluzion. Operatori Ekonomik "Inpress" shpk., pervec te tjerash, per te provuar eksperiencen e ngjashme lidhur me procesin e zarfimit automatik (insertimit) ka paraqitur edhe dy fatura tatimore te cilat jane permendur edhe me lart, perkatesisht:

- i. Fature tatimore shitje, tek blesesi "Interlogistic" shpk., te sherbimeve i produkteve me pershkrim: "Printim te dhenash version zar(a sel(mailer)", me vlere 465.418 (kater qind e gjashtedhjetete e pese mije e kater qind e tetembedhjetete) leke pa TVSH.*
- ii. Fature tatimore shitje, tek blesesi "Marketing & Distribution" shpk. te sherbimeve I produkteve me pershkrim : "Printim te dhenash version zarfa selfmailer", me vlere 2.501.000 (dy milion e pese qind e nje mije) leke pa TVSH.*

Ketu do te donim t'ju bejme me dije se per te kryer procesin e zarfimit automatik (insertimit) dhe procesin selfmailer, perdoret e njejta makineri / pajisje dhe proceset jane shume te ngjashme.

Ne vecanti, do te donim te nenvizionim se Procesi selfmailer, ne fakt, eshte proces pak me kompleks dhe i nderlikuar se procesi i zarfimit automatik (insertimit). Megjithate te dy keto procese Operatori ekonomik "Inpress" shpk., me pervojen e tij i kategorizon tek proceset e thjeshta te shtvpskrimi. Pra, Operatori ekonomik "Inpress" shpk., i permbush te gjitha kriteret e specifikimet teknike ne perputhje te plote me DST -ne, madje i tejkalon ato.

Pra, pretendimi i Komisionit te Vleresimit te Ofertave prane Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane eshte teresisht i pasakte, i pabazuar ne fakte konkrete dhe reale si dhe i paligjshem keshtu qe per kete arsye duhet te shfuqizohet.

5. Nga ana tjeter, do te donim te theksonim se, bazuar ne legjislacionin shqiptar te fushes se prokurimeve publike, ne pergjithesi, si dhe DST se procedures se prokurimit publik ne rastin tone konkret, Autoriteti Kontraktor duhet te pretendoje per pune dhe eksperiencia te nje natyre te ngjashme por kurrsesesi per pune dhe eksperiencia identike.

Komisioni i Prokurimit Publik persa i perket ceshtjes se puneve apo kontratave te ngjashme ka mbajtur nje qendrim konstant , duke parashtruar ne menyre te qarte se:

"...Komisioni i Prokurimit Publik. gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet te vleresoje ne menyre siper(aqesore ngjashmerine midis kontrates objekt prokurimi si edhe kontrates/ kontratave te meparshme te dorezuar nga operatoret ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi per te provuar eksperiencen e tyre te meparshme , por duhet te analizoje elementet konkrete te (urnizimeve te kryera me pare referuar kontratave te ngjashme."...

Ne mbeshtetje te ketij qendrimi konstant te KPP, meposhte Ju pasqyrojme gjithashtu vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. K.P.P 30412016, ne te cilen percaktohet shprehimisht:

"III. 2.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktor ne procesin e shqyrtimit te kontratave te paraqitura per eksperiencia te ngjashme te meparshme duhet te fokusohet jo vetem ne titullin apo objektin e kontrates se ngjashme por duhet te analizoje te gjithe zerat e puneve, mallravel sherbimeve te kontratave te paraqitura, per te verifikuar dhe konkluduar me pas ne kryerjen ose jo te zerave te tille te ngjashem ne kontratat e realizuara me pare.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet te pretendoje per zera te njejte sherbimi dhe te kerkoje eksperiencia te njejta, ne kundersiztim me rregullat e prokurimit publik.

III. 9. Sqarojme se kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshme per t'u permbushur nga te gjitha ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi .

Operatoret ekonomike pjesemarres duhet te vertetojne se zoterojne reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur, per te zhatuar kontraten objekt prokurimi.

111.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjvkon se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se gezojne te gjitha kapacitetet ne (unksion te realizimit me sukses te kontrates.

Ne kete kuptim autoriteti kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale por te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilat vendosen kriteret e percaktuara."

Vendime te tilla te ngjashme te Komisionit te Prokurimit Publik,jane te shumta persa i perket kesaj ceshtje. Duke u rikthyer ne rastin tone konkret , dote donim te parashtronim se:

Punet/ sherbimet/ fumizimet e ngjashme te paraqitura/depozituara nga operatori ekonomik "Inpress" shpk per kete procedure tenderuese jane disa here me te medha dhe me te rendesishme, si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ana cilesore dhe profesionale e realizimit te tyre, ne proporcion me cilesine dhe sasine e mallrave objekt prokurimi. Fakt ky qe verteton qartesisht se Operatori Ekonomik "Inpress" shpk. gezon te gjitha kapacitetet ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Thene ndryshe, OE "Inpress" shpk., bazuar ne dokumentacion e paraqitur /depozituar prane AK , verteton qartesisht se zoteron reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur, per te zbatuar me sukses kontraten objekt prokurimi .

Nga ana tjeter dote donim te theksonim dhe nenvizonim se:

i) Procesi i zarfimit automatik (insertimit) eshte vetem nje nga mijera sherbimet e shtypshkrimit/printimit qe kerkohen ne kete procedure prokurimi. Bazuar ne kete logjike te KVO te AK, nje OE qe operon ne fushen e shtypshkrimeve/printimeve, do te duhet te kete medoemos pune identike per secilin prej ketyre mijera sherbimeve/mallrave nese deshiron te marre pjese ne procedura te ndryshme prokuruese.

ii) Legjislacioni shqiptar i fushes se prokurimeve publike ne fuqi, percakton qartesisht terminologjine "pune ose kontrate" te ngashme. Nese do te merrnim per baze logjiken e KVO-se, se AK, Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane, atehere legjislacioni shqiptar i fushes se prokurimeve publike do te duhet te percaktonte se punet dhe/ose kontratat e

meparshme nuk do te duhet te ishin "te ngjashme", por do te duhet te ishin "te nejta", ose "identikisht te nejta".

Pasi ne logjiken e AK Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane, ne rastin konkret "pune ose kontrate" e ngjashme ne rastin konkret do te duhet te konsiderohet realizimi i puneve/furnizimeve te meparshme ne sherbimin e "zarfimit automatik (insertimit)".

Thene ndryshe, bazuar ne kete logjike, AK Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane, nuk po kerkon "pune te ngjashme, por qartesisht po kerkon "pune te nejta", apo edhe me keq "pune identikisht te nejta". Kerkese kjo qartesisht ne kundersizim si me frymen, ashtu edhe me dispozitat e LPP-se.

iii) Se fundi, do te donim te theksonim se procesi i zarfimit automatik dhe procesi i zarfimit selfmailer, realizohet nepermjet nje procesi shtypi mjaft te thjeshte, dhe nepermjet vetem 1 (nje) pajisje, e cila i kryen te gjitha proceset e punes nga fillimi dhe deri ne nxjerrjen/realizimin e produktit perfundimtar. Per nje OE (shtypshkronje) si "Inpress" shpk., bazuar ne kapacitetet teknike, burimeve njerezore, dhe pajisjet e teknologjise se fundit qe ka ne dispozicion, realizimi i ketij produkt, eshte jo vetem lehtesisht i realizueshem, por hyn tek proceset e thjeshta te shtypshkrimeve I printimeve.

Per te gjitha sa u parashtruan mesiper, kerkojme nga AK, Drejtoria e Pergjithshme e Tarifave dhe Taksave Vendore Tirane:

- a) Ndryshimin e vendimit te KVO-se, duke kualifikuar keshtu OE "Inpress" shpk.;*
- b) Shpalljen fitues se procedures se prokurimit publik, objekt i kesaj ankeses, OE "Inpress" shpk".*

II.3.2. Me anë të shkresës shkresën nr. prot.19090/1, datë 22.05.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje shoqërisë “Inpress” shpk, ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.3.3 Në datën 28.05.2020 operatori ekonomik “Inpress” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.4. Në datën 02.06.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.prot.473/2 shkresa e autoritetit kontraktor nr.11655/19, date 01.06.2020, ku bashkëngjitur ndodhet dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “Nuk ploteson kriterin lidhur me eksperiencën të ngjashme për shërbimin që kërkohej sikurse është specifikuar në DST (teknike) sa i përket menyrës së zarfimit e cila është kërkuar nga autoriteti kontraktor të jetë "... zarfim automatik (insertimi)”; Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.1.1. Në Shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, gërma “a” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar::

“a. Përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë prej 40 % të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

- Për ta vërtetuar këtë duhet:

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të nënshkruara nga të dyja palët (ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara) [...].

III.1.1.1 Ndërsa në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës objekt ankimi është përshkruar në mënyrë të qartë objekti dhe qëllimi i shërbimit objektit prokurimi si më poshtë:

”SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet Teknike për shërbimin e Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2020

<i>Nr</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Karakteristika teknike</i>	<i>Njësia Matjes</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Prodhim fletë njoftim</i>	<i>Zarf DL me dritare për zarfim automatik me logo bardhë e zi + mesatarisht 2.2 fletë të printuara me</i>	<i>Set</i>	<i>89,454</i>

	<i>detyrimi Zarfa dhe zarfimi</i>	<i>të dhëna variable para mbrapa, nga njëri krah me ngjyra+zarfim. Fleteve i duhet vendosur nga një barcode unik në mënyrë që sistemi i zarfimit të bëjë ndarjen e fletëve në çdo zarf. Çdo zarf do të ketë sasi të ndryshme fletësh. Sistemi i prodhimit të OE duhet të jetë në gjëndje ta bëjë vetë ndarjen e fletëve për çdo zarf.</i>		
2	<i>Prodhim fletë njoftim detyrimi</i>	<i>Printimi nga 2 krahet me të dhëna variable bardhë e zi (mesatarisht 2.2 faqe * 89,454 nr.subjecte * 2 kopje njoftim detyrimi)</i>	<i>Faqe</i>	<i>393,598</i>

1. PËRCAKTIMI I FORMATIT TË FLETË DETYRIMEVE

Formati i fletë detyrimeve të kërkuara nga Institucioni jonë për njoftimin e subjekteve në lidhje me detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2020 duhet të jetë:

- *Formati A4, printimi në të dy anët*
- *Përmasat e letrës të jenë 210x297 mm*
- *Lloji letrës 90 gram/m²*
- *Ngjyra e letrës, e bardhë absolute në mënyrë që të ketë kontrast në printim*
- *Të jetë me sipërfaqe të lëmuar*
- *Të plotësojë standartet që letra të ruhet për një periudhë kohe jo më pak se 10 vjet në arkiv.*
- *Dukshmëria: > 94%*
- *Shkëlqimi: 101-104%*
- *Të mos jetë e ricikluar*
- *Numri total i faqeve për tu prituar do të jetë mesatarisht 483.052fletë.*

2. PËRCAKTIMI SPECIFIK I FORMATIT TEKNIK TË PRINTIMIT

- *Marrja e “file-ve” nga kompania duhet të bëhet në mënyrë elektronike në formatin PDF nëpërmjet DVD-ve.*
- *Çdo subjekt për të cilin do të printohet njoftim detyrimi duhet t'i vendoset një numër i caktuar sekuencial.*
- *Për shërbimin e printimit dhe zarfimit lëvrimit duhet të përfundojë brenda 2 ditëve nga dhënia e fileve për print.*

- *Shërbimi i printimit dhe zarfimit duhet të përfundojë brenda afateve ligjore si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar dhe VKB Nr. 158 datë 26.12.2019.*

3. PËRCAKTIMI I FORMATIT TË ZARFIT

- *Zarfi duhet të jetë DL me dritare të pozicionuar në pjesën djathtas poshtë me përmasat e dritares 10x4.5cm.*
- *Përmasat e zarfit të jenë 23x11.5 cm.*
- *Ngjyra e zarfit duhet të jetë e bardhë absolute.*
- *Zarfim automatik me logo bardh e zi plus mesatarisht 2.2 fletë të printuara me të dhëna variable para-mbrapa,*
- *Fletëve i duhet vendosur nga operatori, një barcode unik, në mënyrë që sistemi i zarfimit të bëjë ndarjen e fletëve në çdo zarf dhe të prodhojë raportin përfundimtar të printimit duke ndërtuar një tabelë ku në njërën kolonë të jetë barkodi dhe në tjetrin kodi vendor i tatim paguesit.*
- *Çdo zarf do ketë sasi të ndryshme fletësh. Sistemi i prodhimit të OE duhet të jetë në gjëndje ta bëjë vetë ndarjen e fletëve për çdo zarf.*

4. PERCAKTIMI SPECIFIK I PROÇESIT PER PRINTIMIN E NJOFTIM DETYRIMEVE

- *Pasi të përfundojë proçesi i printimeve për të treja kopjet, i gjithë materiali do të sillet pranë zyrave të DPTTV.*
- *Të treja kopjet do të firmosen nga Titullari dhe vulosen me vulën e institucionit..*
- *Operatori do të tërheqi kopjen e njoftim detyrimit të printuar me ngjyra me qëllim vazhdimin e proçedurës së zarfimit.*
- *Pasi të mbarojë proçesi i zarfimit, zarfat do të sillen pranë zyrave të DPTTV-së.*

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

III.1.2. Neni 28 pika 1 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “*Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specififikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. Ndërsa pika 3 e nenit më sipër parashikon shprehimisht: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë*

jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”.

III.1.2.1. Në vijim në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.1.3. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.*

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësimit të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimues “Inpress” sh.p.k. ka dorëzuar disa fatura tatimore shitjeje, me objekt shërbim printimi për blloqe, dëftesa, certifikata, libra, regjistra, etj.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit dhe në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Referuar në mënyrë specifike objektit të prokurimit, kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor si dhe specifikimeve teknike, Komisioni gjykon se ato në tërësinë e tyre shprehin qartë kërkesën e autoritetit kontraktor për natyrën e shërbimit objekt prokurimi, i cili në rastin konkret nuk ka të bëjë thjesht me një proces të printimit dhe zarfimit të faturave por me një proces i cili është përcaktuar të kryhet sipas një metode të caktuar, zarfim automatic (insertim). Në analizë të të gjithë dokumentacionit të paraqitur në përmbushje të kriterit për *“përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme”*, Komisioni gjykon faturat e paraqitura nuk mund të konsiderohen shërbime të ngjashme pasi nuk përmbajnë karakteristikën dhe specifikën e kërkuar

nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për mënyrën e realizimit të këtij shërbimi (në versionin zarfim automatik (insertim)). Këto kontrata dëshmojnë vetëm për eksperiencën e operatorit ekonomik ankimues për realizimin e shërbimit të printimit, por jo në modelin specifik të kërkuar dhe përcaktuar qartë si në objektin e prokurimit ashtu edhe në specifikimet teknike. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur nuk ka mundur të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor për përvojë e suksesshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme me objekt “zarfim automatik (insertim)”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” shpk për procedurën e prokurimit “Shërbimi i Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2020”, me Nr. REF-50346-02-13-2020, me fond limit 6.649.502 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datën 11.03.2020 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore”.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 473 Protokoli; Datë 28.05.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha